



# Raporti nga monitorimi i procedurave të prokurimit në Ministrinë e Drejtësisë

Për periudhën : 23 Mars - 22 Prill 2011

Prill, 2011

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga mbështetja financiare e” OSI – Instituti për Shoqëri të Hapur si dhe CRD – Mbrojtësit e të Drejtave Civile. Mendimet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdo edhe qëndrime e donatorëve.



## Hyrje

Lëvizja FOL gjatë kësaj periudhe raportuese ka bërë monitorimin e një tenderi me procedurë komplete: atë të “Furnizimit me farëra dhe pesticide”, rivlerësimin e tenderit të “Furnizimit me mish dhe prodhime nga mish”, si dhe hapjen e dy të tjerëve për “Furnizimin me miell, bukë dhe prodhimeve të brumërave” dhe “Furnizimin me automjete për transportin e të burgosurve”.

Gjatë këtij procesi kemi vërejtur disa të mangësi për të cilat mendojmë se zyra e prokurimit pranë MD-së mund të intervenoj para se të filloj hapja e tenderëve, vlerësimi dhe në fund dhënia e kontratës.

Marrë parasysh se Memorandumi mes Lëvizjes FOL dhe Ministrisë së Drejtësisë u nënshkrua me 24/03/11 ende nuk është arritur një komunikim konform parimeve që jemi marrë vesh. Deri më sot ne nuk e kemi një adresë të saktë se cili nga zyrtarët e prokurimit pranë MD-së është përgjegjës për komunikim me Lëvizjen FOL. Ne dosjet e tenderit i kemi pranuar nga zyrtarë të ndryshëm në MD-së dhe jo nga një zyrtarë i caktuar.

**Tenderi për furnizim me farëra dhe pesticide:** edhe pse këtu filluam nga faza e vlerësimit, procesi në përgjithësi shkoj në rregull. Mirëpo gjatë procesit të vlerësimit u gjetën disa mangësi që kanë të bëjnë me gabimet aritmetikore. Edhe pse u kërkua nga zyra e prokurimit pranë MD-së interpretim nga ana e KRPP-së, KRRP-ja u përgjigj në afatin ligjorë, komisioni i vlerësimit nuk arriti të vendosë për fituesin. Si pasojë u vendosë që të shkohet në ritenderim me afat të shpejtuar që do të nënkuptonte 10 ditë, meqë komisioni ra dakord se natyra e këtij tenderimi është i ndjeshëm dhe shumë varet nga kushtet natyrore. Ky komision me 23/03/2011 kërkoi sqarim nga KRRP, një ditë më pas mori përgjigjen nga KRPP. Edhe pse anëtarët e komisionit kërkuan që ky tender të shkoj në ritenderim, arsyetimin nga ana e komisioni e kam pranuar me datën 30/03/2011. Arsyetimi që komisioni ka dërguar zyrës së Prokurimit të MD-së me nr. 528/29/03/11, konsideroj që është në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit dhe efikasitetit dhe plotësisht i ndryshëm nga deklaratimet që ata i dhanë në ditën e vlerësimit.

Duke i konsideruar si neglizhencë këto arsye të paraqitura më lartë, do të japë mendimin për pasojat që do të paraqiten në vijim. Vlera e përafërt e këtij tenderi mund të jetë diku rreth 50.000 Euro duke i krahasuar të 7 ofertat paraprake. Ndonëse anëtarët e komisionit u ranë dakord që ky ritenderim të shkoj me procedurë të shpejtuar brenda 10 ditëve. Mirëpo nga informatat që kamë marrë nga Zyra e prokurimit hapja e këtij tenderi (lexo ritenderim) do të bëhet tek me datën 27/04/11, që do të thotë afro një muaj nga anulimi i tij. Të konsiderojmë se deri te nënshkrimi i kësaj kontrate do të kalojnë vetëm një muaj jo më shumë, duke mos përfshirë këtu kontestimet eventuale nga operatorët ekonomik, si dhe duke paragjykuar se nuk do të ketë ndonjë pengesë tjetër në proces, sipas parashikimeve tona ky tender fillon së zbatuari diku në fillim të qershorit.



### Rekomandim:

Lëvizja FOL kërkon nga Ministria e Drejtësisë të konsultoj ekspert nga fusha e bujqësisë për ta marrë mendimin profesional se a është e mundur që mbjellat të fillojnë në qershor dhe të kemi suksesin e kërkuar. Përndryshe nga praktika vështirë se mundë të besojmë në suksesin e rezultateve të këtij tenderi.

**Tenderi për furnizim me mish dhe prodhime nga mishi:** Edhe pse ky tender ka filluar para se të nënshkruajmë memorandumun, pas vendimit të OSHP-së për ta rivlerësuar ne jemi ftuar të monitorojmë këtë proces.

Ndonëse rreth disa paqartësive për këtë tender kemi pasur një takim me UD e drejtorit të Prokurimit pranë MD-së, konsiderojmë se është dashur të informohemi apo pse jo edhe të ftohemi në takimin mes ministrit dhe AKK-së. Deri më sot kur po raportojmë ende nuk kemi marrë njoftimin zyrtarë se ky tender është anuluar dhe cilat kanë qenë arsyet e MD-së për anulim. Ne parimisht jemi pajtuar me qëndrimin e MD-së lidhur me këtë tender dhe me procedurat që ju keni ndjekur kur keni kërkuar interpretim nga KRRP-ja përkundër vendimit që keni pasur nga OSHP-ja. Andaj mos informimin tonë në kohë e konsiderojmë jo korrekte. Ndërsa nuk kemi ende mendim lidhur me anulimin sepse ne nuk i dimë arsyet se pse është anuluar, po ashtu ne nuk i dimë as arsyet që AKK-ja i ka paraqitur e që sipas mediave ju ka bindur që të vendosni për këtë anulim.

Ndonëse me datën 22/04/2011 kërkuam takim me ministrin për ti sqaruar disa shqetësime që ne kishim lidhur me këtë, edhe pse ky tender tashmë është anuluar megjithatë ne po i paraqesim shqetësimet tona për të cilat kemi pasur t'u informojmë me datën 22 prill. Shqetësimet tona kryesisht kishin të bëjnë me njësinë kërkuese dhe përshkrimet që ata i kanë bërë për produktet e kërkuara si dhe çmimet që ata ju kanë ofruar juve. Meqenë se siç u cek edhe më lartë në këtë tender ne ishim të kyçur tek në fazën përfundimtare dhe nuk kishim pasur mundësin ta analizojmë dosjen e tenderit.

TABELA 1. Njësia kërkuese I ka përshkruar karakteristikat për Operatorët e Ekonomik

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia e përafërt vjetore.
1	Mish i freskët Demi (BUT), pa ashtë dhe minimum dhjamë 5%	Kg	67.000
2	Mish i Bluar Demi, minimum dhjam	Kg	4500
3	Suxhuk origjinal shtëpiak i përgatitur dhe gjysmë i terur, i njëjtë me llojin që shërbehen në mishtore.	Kg	14500
4	Përshutë prej mishit të demit, gjysmë e terur e paketuar në kartuç prej 10 KG .	Kg	7000
5	Pleskavicë (shtëpiake) 100 gr	Kg	5000
	<b>Totali Vlera Euro</b>		<b>386.000.00 Euro</b>



Siç shihet në tabelë, njësia kërkuese në numrin rendor 1 ka paraparë që mishi të jetë me minimum 5% dhjam, që do të thotë kjo i lejon që operatori të sjellë produktin e mishit deri në 25% me dhjam, kjo pa dyshim në kohën e zbatimit të kontratës do të ndikoj dukshëm në çmimin.

Edhe përshkrimi me numrin rendorë 2,3,4 dhe 5 janë të njëjta, i njëjti edhe lejon mundësi të manipulimit.

Më poshtë janë të paraqitura tabelat e dy kompanive asaj “Hajdini Commerce” nga Drenasi dhe “Apetiti” nga Vushtrria për të krahasuar më pas dyshimet e bazuara në keqpërdorim pasi që kontrata të kishte filluar së zbatuari të cilat ne mendojmë se vijnë si rezultat i përshkrimeve që ka bërë njësia kërkuese. E ku ne mendojmë se Zyra e prokurimi ka të drejtë ligjorë të intervenoj.

4. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE Hajdini - Ankuari

Nr	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasitë e përafërta vjetore	Çmimi per njësi	Totali
1	Mish i freskët Demi (but),pa ashte dhe minimum dhjame 5%	kg	67,000.00	4,20	281400
2	Mish i Bluare Demi minimum dhjam	kg	4,500.00	1,99	8955
3	Suxhuk origjinal shtëpiak, i përgatitur dhe gjysm terur	kg	14,500.00	2,00	29000
4	Pleskavic (shtëpiake) 100 gr	kg	5,000.00	2,50	12500
5	Pershut prej mishit te demit ,gjysme e terur paketuare ne kartuç prej 10 kg	kg	7,000.00	4,50	31500
Gjithsej (1+2+3+4+5) totali me të gjitha taksat e aplikuara të RKS					363355 €

Shenoni afatin e liferimit : Në çdo kohë sipas kërkesë suaj edhe në rastet emërgjente, sepse në të gjitha qytetet e Kosovës i kemi pikat e furnizimit.

Tabela II - Përshkrimi dhe çmimet nga Kompania “Hajdini”



F I T U J J A

Numri i prokurimit: 21500-11-003-111– Titulli: Furnizim me mish dhe prodhime nga mish

4. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Nr	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasitë e përafërta vjetore	Çmimi per njësi DDP në	Totali
1	Mish i freskët Demi (but), pa ashte dhe minimum dhjame 5%	kg	67,000.00	5,00€	375200
2	Mish i Bluare Demi minimum dhjam	kg	4,500.00	3,00€	13500
3	Suxhuk origjinal shtëpiak, i përgatitur dhe gjysm terur	kg	14,500.00	3,60€	52200
4	Pleskavic (shtëpiake) 100 gr	kg	5,000.00	3,70€	18500
5	Pershut prej mishit te demit ,gjysme e terur paketuare ne kartuç prej 10 kg	kg	7,000.00	6,20€	43400
Gjithsej (1+2+3+4+5) totali me të gjitha taksat e aplikuarat të RKS				502800,00€	

Shenoni afatin e liferimit Maksimumi 7 ditë

Tabela III - Përshkrimi dhe çmimet nga Kompania "Apetiti"

## Dyshimi (I)

Dyshimet tona të bazuara dhe nga informatat që ne posedojmë nga terreni rreth produktit të përshkruar nën numrin rendorë 4 të njësia kërkuese dhe e njëjta me numrin rendorë 5 tek të dy kompanitë që ka të bëjë me (Pershutë prej mishit të demit, gjysmë e terur e pakeluar në kartuç prej 10kg). Është vështirë të konstatohet pesha statike prej 10 kg. Mendojmë se përshkrimet të tilla bëhen vetëm sa për ti arsyetuar linjat e kërkuara përndryshe nga shumë informata që kemi marrë nga terreni, produkti i përshkruar në këtë linjë as që sërvohet fare për të burgosurit. Po ashtu është e paqartë se a është fjala tek çmimi për njësi në këtë rast çmimi për kilogram apo kartuçi apo çmimi për 10 kilogramë.

## Dyshimi (II)

Si në rastin e parë ashtu edhe tek numri rendor 4, dyshimi jonë i bazuar është se nuk është sqaruar shumë qartë a është fjala për çmimin e 1 pleskavice 100 gr apo për 1 kilogram që do të nënkuptonte 10 copë duhet ti ketë një paketim.



**Njësitë Kërkuese** - Nga analiza e deri tanishme dhe nga konsultimet me ekspertët që kemi pasur kërkojmë nga Zyra e Prokurimit që të intervenoj tek njësitë kërkuese që të jenë të qartë në kërkesat e tyre dhe gjithmonë aty ku përpiluesi i dosjes së tenderit të ketë dyshime të intervenoj dhe ti sqaroj paraprakisht.

**Komisionet e Vlerësimit** - Kërkojmë që nëse lejojnë mundësit ligjore Zyra e Prokurimit varësisht nga lloji i tenderit të kërkoj që anëtarët e komisionit vlerësues të jenë njohës apo profesionist për qëllimin për të cilin ata janë aty.

**Disproporcioni i ofertave**- Edhe pse ligji shpeshë here përcakton kriterin e çmimit qoftë ai më i liri ose ai ekonomikishtë më i favorshëm , mendojmë se duhet të analizohen këto oferta dhe të kërkohej sqarime shtesë nga operatorët me qëllim që të jemi të sigurtë se paratë publike po shpenzohen në mënyrë të drejtë .Dallimet që po ekzistojnë në çmime për të njejtat produkte mendojmë duhet të analizohen paraprakishtë dhe në ato raste kur autoriteti kontraktues konsideron se ka mashtrime në çmim ligji lejon që ky autoritet të merr masa ndaj operatorve për këto mashtrime eventuale.

Gjatë muajit prill ne kemi marrë pjesë në tri hapje të ofertave dhe ate: Furnizimin me miell, bukë dhe prodhimeve të brumërave” dhe “Furnizimin me automjete për transportin e të burgosurve” dhe Furnizimi me pemë dhe perime. Që në të tri këto hapje të ofertave për të njetat produkte , sasi kemi Cmime shumë të dallueshme psh ne në këtë raport do të ofrojmë vetëm një shembull nga këto tre :Tenderi- Furnizimi me pemë dhe perime, nga tre operatorët ekonomik që konkuruan kemi tri oferta me : Oferta e I 183.930 e dyta 202.355 dhe e treta 307.975E, nëse në këtë tender kriter do të jetë Cmimi më i lirë atëhere supozojmë se ofertuesi i parë fiton. Dallimi mes ofertuesit të parë dhe ati të tretë është 124.045. Po ashtu në rastë se kriteri do të jetë cmimi ekonomikishtë më i favorshëm , dallimi mes operatorit të II dhe ati të tretë do të ishte 105.620E.Pavarësishtë se procedura është e hapur lëvizaj Fol konsideron që autoriteti kontraktues në këtë rastë të bëjë krahasime mes këtyre operatorve ekonomik për të parë se si është e mundur që Operatori i I të jetë kaqë shumë i lirë ngai i Treti dhe nesë shpërblehet atëhere të monitorohet më përpikëmeri ose në rastë dyshimi edhe të akuzohet për mashtrime në çmime.

Në shembullin e cekur ende jemi në fazën e hapjës së ofertës dhe nuk e dimë ende deri në procedurën e vlerësimit se cilat janë cmimet e ofruara për secilën njësi nga këta operatorë për të dhënë një opinion dyshimi reth mashtrimëve në cmime.

Mirëpo nëse rikthehemi tek tenderi i produktëve të mishit , atëhere ju njoftojmë se në një anketë anonime me telefon të 10 pronarëve të shitoreve të mishit në 3 qytete të Kosovës në pyetjen se “në rastë të blerjës së 20.000 kilogram mishi të bluar të përpunaur në pleskavica prej 100 gram më cmimin psh 2.50 që 10 këto shitore kanë përjashtuar mundësin e furnizimit me këtë cmim pavarësishtë sasisë.Ndërsa në tenderin e anuluar nga ana juaj njëri nga operatorët ekonomik ka ofruar këtë cmim.